



KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË
UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT



NJOFTIM

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në bazë të nenit 94 paragrafi (2) të Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19) duhet që secilin vit të përgatisë plan të zhvillimit të sistemit për periudhën prej pesë vitet e ardhshme dhe me miratimin e mëparshëm nga Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës), ta miratojë planin dhe ta publikojë në faqen e tij të internetit.

ELEKTRODISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup, më 31 dhjetor 2021 deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dërgoi për miratim Planin e përditësuar të Zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për periudhën 2021-2025 nr. 12- 2210/ 3 datë 31 dhjetor 2020.

Duke pasur parasysh se pas ndërprerjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende ekziston pandemi nga sëmundje ngjitëse dhe është shpallur gjendja e krizës, ndërsa në interes të ruajtjes së shëndetit të palëve, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka vendosur që të mos mbahen seanca përgatitore dhe komunikimi me palët e interesuara të zhvillohet në mënyrë elektronike.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, në linkun e mëposhtëm është Plani i Zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për periudhën 2021-2025 të dërguar nga ELEKTRODISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup, për të cilin më së voni deri më 20 janar 2021 mund të dërgoni vërejtje, komente dhe sugjerime në erc@erc.org.mk.

Me respekt,

**Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit
të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

[Plani i Zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për periudhën
2021-2025 të dërguar nga ELEKTRODISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup](#)

